STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

**Për njoftim të menjëhershëm:** 4 nëntor 2012

# GUVERNATORI CUOMO PEZULLON RREGULLAT PËR TË LEJUAR DONACIONET ME UJË TË PIJSHËM PËR NJUJORKEZËT E PREKUR NGA URAGANI SANDY

Guvernatori Andrew M. Cuomo udhëzoi modifikimin e rregullave shtetërore dhe lejimin e përkohshëm të shpërndarjes së mijëra arkave me ujë të pijshëm për njujorkezët në zonat e goditura rëndë nga uragani Sandy.

Për lejimin e shpërndarjes së këtyre donacioneve me ujë, guvernatori lëshoi një Urdhër Ekzekutiv për të pezulluar dhe modifikuar rregullat e Departamentit të Shëndetësisë për ujin e pijshëm në shishe dhe në sasi më të mëdha për industrinë prodhuese. Departamenti shtetëror për Ruajtjen e Mjedisit (DEC) lëshoi leje për kërkesat për depozitimin e ujit të dhuruar nga prodhuesit dhe do të shqyrtojë edhe kërkesa të tjera për këto leje.

“Është me rëndësi kritike që furnizimet me ujë të pijshëm të pastër tu shkojnë njujorkezëve në nevojë sa më shpejt që të jetë e mundur”, tha guvernatori Cuomo. “Veprimet e ndërmarra nga shteti sot për të ndihmuar kompanitë të shpërndajnë ujin në shishe komuniteteve të goditura rëndë janë një gjë e drejtë dhe praktike, duke ruajtur në të njëjtën kohë shëndetin publik. Unë falënderoj kompanitë për donacionet e tyre për të ndihmuar njujorkezët gjatë kësaj kohe emergjence”.

Kompania Anheuser-Busch ka paketuar mijëra arka me shishe me ujë të pijshëm për tua dhuruar komuniteteve që përballen me mungesa të mëdha të ujit për shkak të uraganit Sandy. Meqenëse zakonisht kompania nuk prodhon ujë të pijshëm që shpërndahet në Nju Jork, ajo nuk kishte certifikatën e domosdoshme për të shpërndarë produkte të tilla. Pas shqyrtimit, ekspertët e ujit të pijshëm në Departamentin e Shëndetësisë mbetën të kënaqur sepse uji është i përshtatshëm për konsum nga njeriu.

Urdhri Ekzekutiv i guvernatorit pezullon dhe modifikon rregullat e Departamentit të Shëndetësisë me qëllim që uji i Anheuser-Busch mund të dhurohet në kuadrin e përpjekjeve për ndihmat kundër fatkeqësisë. Ajo autorizon gjithashtu Komisionerin e Shëndetësisë të lejojë donacione shtesë kur ai mendon se janë plotësuar standardet e sigurisë së produktit.

Përveç Anheuser-Busch, Walmart gjithashtu do të dhurojë ujë në shishe për zonat e goditura nga uragani në qytetin e Nju Jorkut.

Për të mbështetur këto donacione uji, DEC nuk do të zbatojë disa dispozita të Ligjit shtetëror për Kontejnerët e Kthyeshëm, që njihet përgjithësisht si Ligji për Shishet, për ujin e pijshëm që

dhurohet në kuadrin e përpjekjeve për lehtësimin e fatkeqësisë deri më 9 nëntor 2012. Ligji për Shishet aktualisht kërkon që çdo shishe pijeje që shitet apo shpërndahet në Nju Jork të ketë depozitën që grumbullohet nga një iniciator i regjistruar depozite dhe çdo shishe duhet ta ketë të treguar qartë vlerën e rikthimit të Nju Jorkut. DEC nuk do të detyrojë zbatimin e këtyre kërkesave për ujin e pijshëm të dhuruar nga Anheuser-Busch dhe Walmart gjatë kësaj periudhe. DEC do të marrë në konsideratë edhe kërkesat për moszbatimin e rregullave edhe nga kompani të tjera që dëshirojnë të dhurojnë ujë në kuadrin e ndihmës për rimëkëmbjen.

Qendrat e kompensimit, konsumatorët dhe shitësit me pakicë duhet të vihen në dijeni se mund të ketë shishe uji për të cilat nuk është bërë pagesa e depozitës prandaj ato nuk duhet të kthehen për kompensim. Këto shishe duhet të riciklohen përmes programeve të rregullta të riciklimit të plastikës dhe metaleve.

###

Lajme të tjera do t'i gjeni në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418